



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.149**

**8 nëntor**

**2007**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

|                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |      |
|---------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Vendim i Kuvendit<br>nr.137, datë 1.11.2007 | Për përbërjen e Komisionit Hetimor “Mbi përgjimet e paligjshme të telefonave”.....                                                                                                                                                                                                                                                                        | 4371 |
| Vendim i Kuvendit<br>nr.138, datë 1.11.2007 | Për disa ndryshime në vendimin nr.130, datë 22.10.2007 “Për përbërjen e Komisionit Hetimor “Për hetimin e objektit dhe procedurave të kontratës së privatizimit të Albtelekomit për periudhën 2001 e në vijim””.....                                                                                                                                      | 4371 |
| Vendim i Kuvendit<br>nr.139, datë 1.11.2007 | Për një ndryshim në vendimin nr.131, datë 22.10.2007 “Për përbërjen e Komisionit Hetimor “Për hetimin e shpenzimeve të Buxhetit të Shtetit në dispozicion të ministrive, institucioneve kryesore të varësisë dhe ndërmarrjeve publike nëpërmjet prokurimeve publike për periudhën 2001 e në vijim””.....                                                  | 4372 |
| Vendim i Kuvendit<br>nr.140, datë 1.11.2007 | Për një ndryshim në vendimin nr.132, datë 22.10.2007 “Për përbërjen e Komisionit Hetimor “Për zbatimin e ligjit të koncesioneve, dhënien me koncesion të objekteve të ndryshme në pronësi shtetërore, kushtet e dhënies së këtyre kontratave për periudhën 2001 e në vijim dhe procedurat për fillimin e punimeve për ndërtimin e TEC-it të Vlorës””..... | 4372 |
| Vendim i Kuvendit<br>nr.141, datë 5.11.2007 | Për miratimin e raportit përfundimtar të Komisionit Hetimor “Për shqyrtimin e kërkesës për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm”, ngritur me vendimin e Kuvendit nr.135, datë 25.10.2007 .....                                                                                                                      | 4373 |
| Vendim i Kuvendit<br>nr.142 datë 5.11.2007  | Për zgjedhjen e komisionerëve të Avokatit të Popullit .....                                                                                                                                                                                                                                                                                               | 4373 |
| Vendim i KM                                 | Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike                                                                                                                                                                                                                                                                                        |      |

|                                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |      |
|----------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| nr.697, datë 19.10.2007                | shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Rrëshen të qarkut të Lezhës.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | 4374 |
| Vendim i KM<br>nr.710, datë 24.10.2007 | Për transferimin në pronësi të disa bashkive të pronave, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, dhe për disa ndryshime në vendimin nr.60, datë 1.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Social Shtetëror” .....                                                                                                                             | 4376 |
| Vendim i KM<br>nr.712, datë 24.10.2007 | Për shfuqizimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.317, datë 30.9.1947 “Për krijimin e ndërmarrjes minerare të qymyrgurit, me qendër në Tiranë”, nr.304, datë 15.7.1949 “Për krijimin e ndërmarrjes minerare shtetërore të qymyrgurit, Memaliaj”, nr.236, datë 14.6.1957 “Për krijimin e ndërmarrjes shtetërore të hekur-nikelit, Pishkash”, nr.403, datë 8.10.1957 “Për krijimin e ndërmarrjes shtetërore të qymyrgurit, Pishkash” dhe nr.339, datë 12.10.1962 “Mbi krijimin e NMSH hekur-nikeli, Guri i Kuq”, ..... | 4377 |
| Vendim i KM<br>nr.725, datë 7.11.2007  | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.529, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave të aplikimit e të miratimit të lejeve të ndërtimit të linjave tregtare të interkonjeksionit” .....                                                                                                                                                                                                                                                                                 | 4377 |
| Vendim i ERE<br>nr.61, datë 2.11.2007  | Për dhënien e licencës për ndërtim, instalim dhe shfrytëzim të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale “HERA” sh.p.k. (Projekti KAPPET).....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | 4378 |
| Vendim i ERE<br>nr.62, datë 2.11.2007  | Për fillimin e procedurave të shqyrtimit për rinovim të licencës për shoqërinë “GSA” sh.p.k., për aktivitetin e importit të energjisë elektrike .....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | 4379 |

**VENDIM**  
**Nr.137, datë 1.11.2007**

**PËR PËRBËRJEN E KOMISIONIT HETIMOR “MBI PËRGJIMET  
E PALIGJSHME TË TELEFONAVE”**

Në mbështetje të nenit 77 pika 2 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit” dhe të vendimit nr.128, datë 11.10.2007 të Kuvendit, me propozimin e grupeve parlamentare,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Komisioni Hetimor “Mbi përgjimet e paligjshme të telefonave” përbëhet nga këta anëtarë:

- |                      |                 |
|----------------------|-----------------|
| 1. Jak Ndokaj        | Kryetar         |
| 2. Stefan Çipa       | Zëvendëskryetar |
| 3. Petrit Gjoni      | Anëtar          |
| 4. Rahim Kaleci      | “               |
| 5. Sali Shehu        | “               |
| 6. Artur Hasanbelliu | “               |
| 7. Fatmir Xhindi     | “               |
| 8. Gëzim Musabelliu  | “               |
| 9. Sabit Brokaj      | “               |

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.138, datë 1.11.2007**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.130, DATË 22.10.2007  
“PËR PËRBËRJEN E KOMISIONIT HETIMOR “PËR HETIMIN E OBJEKTIT DHE  
PROCEDURAVE TË KONTRATËS SË PRIVATIZIMIT TË ALBTELEKOMIT PËR  
PERIUDHËN 2001 E NË VIJIM””**

Në mbështetje të nenit 77 pika 2 të Kushtetutës, të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit” dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e grupeve parlamentare,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Deputeti Gëzim Musabelliu zëvendëson deputetin Albert Divjaka në Komisionin Hetimor “Për hetimin e objektit dhe procedurave të kontratës së privatizimit të Albtelekomit për periudhën 2001 e në vijim”.

II. Deputetja Ermelinda Meksi zëvendëson deputetin Stefan Çipa në këtë Komision.

III. Deputeti Paskal Milo zëvendëson deputetin Dritan Prifti në këtë Komision.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**

**Nr.139, datë 1.11.2007**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.131, DATË 22.10.2007 “PËR PËRBËRJEN E KOMISIONIT HETIMOR “PËR HETIMIN E SHPENZIMEVE TË BUXHETIT TË SHTETIT NË DISPOZICION TË MINISTRIVE, INSTITUCIONEVE KRYESORE TË VARËSISË DHE NDËRMARRJEVE PUBLIKE NËPËRMJET PROKURIMEVE PUBLIKE PËR PERIUDHËN 2001 E NË VIJIM””**

Në mbështetje të nenit 77 pika 2 të Kushtetutës, të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, të pikës III të vendimit nr.126, datë 8.10.2007 të Kuvendit dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e grupeve parlamentare,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Deputetja Arenca Trashani nuk do të jetë anëtare e Komisionit Hetimor “Për hetimin e shpenzimeve të Buxhetit të Shtetit në dispozicion të ministrive, institucioneve kryesore të varësisë dhe ndërmarrjeve publike nëpërmjet prokurimeve publike për periudhën 2001 e në vijim” dhe deputeti Andis Harasani shtohet si anëtar në këtë Komision.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE  
Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM  
Nr.140, datë 1.11.2007**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.132, DATË 22.10.2007 “PËR PËRBËRJEN E KOMISIONIT HETIMOR “PËR ZBATIMIN E LIGJIT TË KONCESIONEVE, DHËNIEN ME KONCESION TË OBJEKTEVE TË NDRYSHME NË PRONËSI SHTETËRORE, KUSHTET E DHËNIES SË KËTYRE KONTRATAVE PËR PERIUDHËN 2001 E NË VIJIM DHE PROCEDURAT PËR FILLIMIN E PUNIMEVE PËR NDËRTIMIN E TEC-IT TË VLORËS””**

Në mbështetje të nenit 77 pika 2 të Kushtetutës, të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit” dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e grupit parlamentar të PSD,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Deputeti Albert Divjaka zëvendëson deputetin Gëzim Musabelliu në Komisionin Hetimor “Për zbatimin e ligjit të koncesioneve, dhënie me koncesion të objekteve të ndryshme në pronësi shtetërore, kushtet e dhënies së këtyre kontratave për periudhën 2001 e në vijim dhe procedurat për fillimin e punimeve për ndërtimin e TEC-it të Vlorës”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE  
Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM  
Nr.141, datë 5.11.2007**

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË KOMISIONIT HETIMOR “PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR NISJEN E PROCEDURËS SË SHKARKIMIT NGA DETYRA TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM”, NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR.135, DATË 25.10.2007**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 22 të ligjit nr.8891 datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit” dhe të nenit 114 pika 3 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Miratohet Raporti Përfundimtar, konkluzionet dhe rekomandimet e Komisionit Hetimor “Për shqyrtimin e kërkesës për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm”, ngritur me vendimin e Kuvendit nr.135, datë 25.10.2007, sipas tekstit të bashkëlidhur këtij vendimi (me propozimin për shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm Theodhori Sollaku).

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE  
Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM  
Nr.142 datë 5.11.2007**

**PËR ZGJEDHJEN E KOMISIONERËVE TË AVOKATIT TË POPULLIT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Avokatit të Popullit,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Zgjidhen në detyrën e komisionerit të Avokatit të Popullit:

1. Zonja Florina Tegu (Nuni)
2. Zoti Skënder Haluci
3. Zoti Riza Poda

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE  
Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM  
Nr.697, datë 19.10.2007**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE**

**SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË  
RRËSHEN TË QARKUT TË LEZHËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Rrëshen të qarkut të Lezhës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Rrëshen të qarkut të Lezhës, miratuar me vendimin nr.11, datë 13.1.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Rrëshen”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Rrëshen për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
Sali Berisha**

Bashkia Rrëshen

Lidhja 1

| <b>Numri rendor i pronës në listën e inventarit</b>                                              | <b>Fusha e përdorimit të pronës</b>                                                       | <b>Lloji i transferimit</b> |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------|
| 12, 13-19, 21-23, 25-27, 29-34, 38, 39                                                           | Prona që përdoren në fushën administrative                                                | Në pronësi                  |
| 40-43, 45-55                                                                                     | Prona që përdoren në fushën arsimit dhe shëndetësisë (pronat janë në të njëjtat ndërtesa) | Në pronësi                  |
| 1185                                                                                             | Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes kombëtare                                         | Në pronësi                  |
| 58-65                                                                                            | Prona që përdoren në realizimin e programeve sportive dhe kulturore                       | Në pronësi                  |
| 66-80, 102, 103, 104, 106, 109-116, 118-136, 138-141, 143-144, 146-155                           | Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik                                         | Në pronësi                  |
| 81-99                                                                                            | Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile                                            | Në pronësi                  |
| 100                                                                                              | Prona që përdoren në fushën e shërbimit social                                            | Në pronësi                  |
| 1187-1191, 1193-1196, 1198, 1199, 1201-1203, 1205, 1206, 1208-1210, 1212, 1213, 1215, 1216, 1218 | Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë bujqësore)                     | Në përdorim                 |
| 1192, 1197, 1200, 1204, 1207, 1211, 1214, 1217                                                   | Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë                                | Në pronësi                  |

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |                                                                                 |             |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------|-------------|
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | jobujqësore kanale të treta)                                                    |             |
| 1220                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | Prona që përdoren në fushën e ndriçimit publik                                  | Në pronësi  |
| 1229, 1230, 1234-1236, 1238, 1241, 1257, 1258, 1261, 1262, 1265-1271, 1274-1280, 1284-1287, 1289-1308, 1310, 1312, 1313, 1315-1320, 1324, 1325, 1327-1331, 1333-1339, 1341-1343, 1347, 1349, 1354, 1355, 1381, 1386-1397, 1399, 1400, 1405, 1409, 1410, 1415-1417, 1419, 1427, 1428, 1441, 1442, 1438, 1439, 1566, 1590, 1593, 1594, 1604, 1605, 1607, 1612, 1613, 1615, 1618-1620, 1622-1626, 1629-1634, 1637-1639, 1641, 1644-1648, 1650, 1651, 1653, 1654, 1660, 1671, 1677-1680, 1686, 1687, 1745-1754, 1756-1759, 1764, 1770-1773, 1775, 1776, 1777-1786, 1788-1800, 1802-1806, 1808, 1809, 1812-1834, 1836-1838, 1840-1854, 1856, 1857, 1861, 1910, 1911, 1929, 1943, 1991-1999, 2033, 2035-2037, 2040, 2041, 2043, 2045-2049, 1862-1866, 1872, 1873, 1883-1885, 1886, 1889, 1891-1895 | Infrastrukturë vendore (rrugë, lulishte, trotuar, sheshe)                       | Në pronësi  |
| 1356-1380, 1382-1385, 1398, 1401-1404, 1406-1408, 1411-1414, 1418, 1420-1426, 1429-1434, 1436, 1437, 1440, 1443-1450, 1221-1228, 1231-1233, 1237, 1240, 1242-1256, 1259, 1260, 1263, 1264, 1283, 1309, 1314, 1321, 1332, 1344-1346, 1350-1353, 1555-1557, 1559-1565, 1567-1589, 1591, 1592, 1595-1603, 1606, 1608, 1609-1611, 1614, 1616, 1617, 1627, 1628, 1635, 1636, 1640, 1643, 1649, 1652, 1661-1664, 1669, 1670, 1672-1676, 1688-1744, 1755, 1760-1763, 1765, 1766, 1774, 1787, 1801, 1807, 1810, 1811, 1835, 1839, 1855, 1858-1860, 1904-1909, 1912-1928, 1930-1942, 1944-1990, 2007-2032, 2034, 2038, 2039, 2042, 2044, 2050-2101, 1867-1870, 1874-1882, 1887, 1888, 1890, 1896                                                                                                      | Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës (sheshe, troje, hapësira publike) | Në përdorim |

**VENDIM**  
**Nr.710, datë 24.10.2007**

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË DISA BASHKIVE TË PRONAVE, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.60, DATË 1.2.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 2 e 3 të nenit 42 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të neneve 4, 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të disa bashkive të pronave, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, të miratuara me vendimin nr.60, datë 1.2.2006 të Këshillit të Ministrave, si më poshtë vijon:

a) objekti me numër rendor 3, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore “Qendra ditore polivalente për shërbime sociale”, Kamëz të kalojë në pronësi të bashkisë së Kamzës;

b) objekti me numër rendor 10, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore “Qendër rezidenciale shërbimesh për fëmijët shkollorë 6-14 vjeç”, Shkodër të kalojë në pronësi të bashkisë së Shkodrës.

2. Këto prona të hiqen nga lista e inventarit të pronave shtetërore, miratuar me vendimin nr.60, datë 1.2.2006 të Këshillit të Ministrave.

3. Institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi dhe shërbimi shoqëror, që ofrohet në to, të transferohen së bashku me ndërtesën, fondet, pajisjet, inventarin, personelin dhe dokumentacionin përkatës.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2007, grupi 25, titulli 10430, kap.1, artikujt 600, 601 dhe 602, miratuar për këtë vit për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, dhe në vijim nga buxhetet vjetore përkatëse.

5. Njësitë të qeverisjes vendore, të përcaktuara në shkronjat “a” e “b” të pikës 1 të këtij vendimi, u ndalohet ndryshimi i destinacionit të përdorimit të pronave, tjetërsimi apo dhënia në përdorim të tretëve.

6. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, kryetarët e bashkive të përmendura në pikën 1 dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

#### VENDIM Nr.712, datë 24.10.2007

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMEVE NR.317, DATË 30.9.1947 “PËR KRIJIMIN E NDËRMARRJES MINERARE TË QYMYRGURIT, ME QENDËR NË TIRANË”, NR.304, DATË 15.7.1949 “PËR KRIJIMIN E NDËRMARRJES MINERARE SHTETËRORE TË QYMYRGURIT, MEMALIAJ”, NR.236, DATË 14.6.1957 “PËR KRIJIMIN E NDËRMARRJES SHTETËRORE TË HEKUR-NIKELIT, PISHKASH”, NR.403, DATË 8.10.1957 “PËR KRIJIMIN E NDËRMARRJES SHTETËRORE TË QYMYRGURIT, PISHKASH” DHE NR.339, DATË 12.10.1962 “MBI KRIJIMIN E NMSH HEKUR-NIKELI, GURI I KUQ”, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 31 të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, të ndryshuar dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimeve nr.317, datë 30.9.1947 “Për krijimin e ndërmarrjes minerare të qymyrgurit, me qendër në Tiranë”, nr.304, datë 15.7.1949 “Për krijimin e ndërmarrjes minerare shtetërore të qymyrgurit, Memaliaj”, nr.236, datë 14.6.1957 “Për krijimin e ndërmarrjes shtetërore të hekur-nikelit, Pishkash”, nr.403, datë 8.10.1957 “Për krijimin e ndërmarrjes shtetërore të qymyrgurit, Pishkash”, dhe nr.339, datë 12.10.1962 “Mbi krijimin e NMSH hekur-nikeli, Guri i Kuq”, të Këshillit të Ministrave.

2. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për nxjerrjen e akteve nënligjore, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.725, datë 7.11.2007**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.529, DATË 15.8.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE TË APLIKIMIT E TË MIRATIMIT TË LEJEVE TË NDËRTIMIT TË LINJAVE TREGTARE TË INTERKONJEKSIONIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.9776, datë 12.7.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në tekstin, që i bashkëlidhet vendimit nr.529, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

**KRITERET DHE PROCEDURAT PËR APLIKIMIN DHE MIRATIMIN E LEJEVE PËR NDËRTIMIN E LINJAVE TREGTARE TË INTERKONJEKSIONIT**

Në tekstin “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave të aplikimit e të miratimit të lejeve të ndërtimit të linjave tregtare të interkonjeksionit” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Pika 2.3, germa “b” bëhet:

b) Karakteristikat kryesore teknike të linjës së interkonjeksionit, përfshirë edhe vendet e parashikuara për lidhjen e linjës me sistemin elektrik të transmetimit kombëtar dhe me rrjetin e transmetimit të vendeve fqinje.

Pika 2.3, germa “c” bëhet:

c) Kapacitetin neto të transmetimit, që ai kërkon, në raport me kapacitetin e përgjithshëm të linjës së interkonjeksionit, si dhe duke përcaktuar qartë vitet për të cilat kërkohet leja, duke argumentuar se moslëshimi i lejes nga institucionet shtetërore shqiptare, në afatet e kërkuara, do ta bënte realizimin e linjës së interkonjeksionit ekonomikisht joefektiv.

Pika 2.4 hiqet.

Tek pika 4.1, germa “d” dhe paragrafi i dytë i germës “dh”, hiqen.

Pika 4.3 bëhet:

Ministria konkludon mbi dhënien e lejes brenda 60 ditëve nga marrja e kërkesës për dhënien e lejes, pasi të ketë marrë mendimin e Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike, si dhe të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.).

Tek pika 4.7, pas paragrafit “iii” shtohet paragrafi “iv”, me këtë përmbajtje:

iv. Kushtin që punimet nuk duhet të fillojnë, në qoftë se kërkuar nuk paraqet lejet dhe autorizimet e nevojshme për ndërtimin e kësaj linje dhe lidhjen e saj me sistemin energjetik të vendit me të cilin bëhet

lidhja, të lëshuara nga autoritetet përkatëse të vendit fqinj, si dhe dokumentacioni përkatës që provon fillimin e ndërtimit të burimit gjenerues të energjisë elektrike, për transmetimin e së cilës është kërkuar ndërtimi i kësaj linje.

Shpenzimet që kërkuesi ka kryer deri në këtë fazë, përballohen nga ana e tij dhe institucionet publike shqiptare nuk kanë asnjë detyrim.

Tek pika 4.7, shtohet “v”, me këtë përmbajtje:

v. Kushtin që punimet nuk duhet të fillojnë, në qoftë se kërkuesi nuk paraqet marrëveshjen me autoritetet kompetente të të dy vendeve për mënyrat e aksesit apo të përdorimit të linjës së interkonjeksionit.

vi. Kushtin për vlefshmërinë e lejes, që në rast se brenda 12 muajve nga dita e lëshimit të kësaj leje, nuk plotësohen kërkesat e paragrafëve “iv” dhe “v” të mësipërm, leja revokohet.

## **VENDIM Nr.61, datë 2.11.2007**

### **PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR NDËRTIM, INSTALIM DHE SHFRYTËZIM TË CENTRALEVE ELEKTRIKE ME ERË, SI DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KËTO CENTRALE “HERA” SHPK (PROJEKTI KAPPET)**

Në zbatim të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” me ndryshimet përkatëse, neni 13, pika 1, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007 “Për miratimin e rregullores për procedurat e licencimit”, neni 11, pika 1, neni 13, pikat 1 dhe 2, vendimit nr.44, datë 24.7.2007 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, neni 15, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 2.11.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “HERA” sh.p.k. për marrje licence për aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centralit elektrik me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale,

#### **VENDOSI:**

I. Dhënie e licencës shoqërisë “HERA” sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike (Projekti KAPPET), me fuqi 150 MGW, duke plotësuar kushtet e mëposhtme:

1. Brenda një afati kohor 9-mujor të realizojë:

- Sigurimin e dokumenteve të pronësisë, duke realizuar kalimin nga premtim shitjeje në titull pronësie dhe realizimin e kontratave të huapërdorjes ose qiramarrjes, për të gjithë sipërfaqen e nevojshme për realizimin e projektit.

- Kryerjen e një studimi fisibiliteti, që kushtëzohet me instalimin e kullave vrojtuese për të eksperimentuar në kushtet reale dhe nxjerrjen e konkluzioneve definitive për projektin e zbatimit. Përcaktimi në këtë studim edhe i kostos së prodhimit të energjisë elektrike. Ky studim të paraqitet në ERE përpara fillimit të zbatimit të punimeve. Për këtë shoqëria duhet të sjellë grafikun e rishikuar të punimeve.

2. Shoqëria “HERA” sh.p.k. duhet të paraqesë pranë ERE-s, marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a.-në, përpara fillimit të ndërtimit të objektit, ku të jenë të specifikuara detyrimet e ndërsjella, që rrjedhin nga Kodi i Transmetimit.

3. Shoqëria “HERA” sh.p.k. do të respektojë detyrimet e shërbimit publik që do të rrjedhin në zbatim të nenit 25 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

4. Koha e zbatimit të gjithë projektit përfshirë dhe kolaudimin e veprës, duke iu referuar datës së lëshimit të licencës të jetë 36 muaj.

II. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S  
Bujar Nepravishta**

## **VENDIM Nr.62, datë 2.11.2007**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT PËR RINOVIM TË LICENCËS PËR  
SHOQËRINË “GSA” SHPK PËR AKTIVITETIN E IMPORTIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13, pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007 “Për miratimin e rregullores së procedurave të licencimit”, neni 10, pikat 1 dhe 2, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.44, datë 24.7.2007 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, neni 18, pika 1 dhe neni 19, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 2.11.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “GSA” sh.p.k., për rinovimin e licencës në aktivitetin e importit të energjisë elektrike,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës, për rinovimin e licencës për shoqërinë “GSA” sh.p.k., për aktivitetin e importit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, si dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojnë aplikuesin për dërgimin e dokumenteve të munguara në përputhje me kërkesat e “Rregullores për procedurat e licencimit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S  
Bujar Nepravishta**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)**  
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. REGJISTRAT E NOTERISË
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

## BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PUNËS

KODI I FAMILJES

PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL

### ***Së shpejti në treg:***

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat

Hyri në shtyp më 8.11.2007  
Doli nga shtypi më 8.11.2007

|                    |                  |
|--------------------|------------------|
| Tirazhi: 3500 copë | Formati: 61x86/8 |
|--------------------|------------------|

Shtypshkronja “Nënë Tereza”  
Tiranë, 2007

Çmimi 12 lekë